



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 112-02/32269, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 17.paragrafi 1 pika h) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.Qershor 2008”), neni 35, pikat 1,2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5, pika d të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet Republikës së Kosovës, Neni 8, paragrafi 14 të Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar dhe nenit 13 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në propozim të Kryetarit të komunës, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Nr. 38/2025

Mbi formimin e Komisionit të zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues parauniversitar në Komunën e Pejës

1. Formohet Komisioni i zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues parauniversitar në Komunën e Pejës, në përbërje:

1. **Shqipe Karagjyzi**, Udhëheqëse e Sektorit të Arsimit, përfaqësues nga DKA (kryesuese e komisionit)
2. **Qefere Grapci**, Përfaqësuese i këshillit të prindërve në nivel komunal, dhe
3. Një përfaqësues nga MASHTI.
4. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAA-AP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.

2. Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit nga pika 1 e këtij vendimi, janë përcaktuar me Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.

3. Për zbatimin këtij vendimi dhe koordinim të punës së Komisionit do të kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit - Pejë, në bashkëpunim me MASHTI, dhe AAPARRr.

4. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

Kryetarit të Komunës,

MAPL,

MASHTI,

DKA,

Anëtarëve të komisionit,

Arkivë.

